

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E SUPERINTENDENTIT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301

PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.
SUPERINTENDENT
4104

TELEFON (215) 400-4100
FAKS (215) 400-

10 Qershor 2013

Të dashur Prindër/Kujdestarë:

Me ardhjen e shpejtë të pushimeve verore, do të dëshiroja që t'ju informoja për shumë programe verore për fëmijët, që do të ofrohen nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias, agjensitë e qytetit dhe organizat jo fitimprurëse lokale.

Uebajti i Programeve Verore të Drejtorisë Arsimore (www.philasd.org/summerprograms) përfshin informacione për aktivitetet që pasurojnë përvojën mësimore, programe të sponsorizuara nga partnerët e komunitetit dhe listat e leximit për nxënësit nga arsimi parashkollor deri në klasën e 11^{te}. Ju mund të gjeni detaje në fushat e mëposhtëme.

- **Programet e Qytetit të Filadelfias për të Rinjtë (City of Philadelphia Youth Programs)** (www.phila.gov/youthprograms) – Nisma "Have a "Fun, Safe Philly Summer" me programe verore falas, ose me kosto të ulët. Nëpërmjet bashkëpunimit me Qytetin e Filadelfias, do të hapen kampe verore në shumë prej shkollave tona. Ushqimi do të jetë falas për fëmijët e moshës deri 18 vjeç. Vizitoni www.phillysummermeals.com, ose telefononi 311 që të gjeni kampin veror më të afërt me ushqim.
- **Partnershipet e Aktiviteteve Pas Shkollore (ASAP/After School Activities Partnerships)** (www.phillyasap.org) – Shumë prej programeve jashtëshkollore do të zhvillohen në programet verore. Për detajet, klikoni në "Directory." Programi informativ do të jetë specifik për vitin shkollor, kështu që kontaktoni direkt për informacionet rreth ofertave verore.
- **Bashkësia e Filadelfias & Jugut të Nju Xhersit (United Way of Greater Philadelphia and Southern New Jersey)** ka një uebsajt (<http://211sepa.org>), ku ju mund të merrni informacion për programet e verës. Ju mund të shikoni listat në <http://www.nj211.org/sepa/images/SummerCampActivityPrograms2013.pdf>. Në rast se nuk keni akses në internet, ju lutemi telefononi 2-1-1 ose 866-964-7922 për asistencë.

Ne do të kërkonim që të filloni planifikimin sa më shpejt, pasi shumë prej programeve bëjnë regjistrimet mbi parimin e regjistrimit kush vjen i pari. Ju lutemi ndajeni këtë informacion me miqtë, shokët dhe fqinjët tuaj.

Sinqerisht,



William R. Hite, Jr., Ed.D.